



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelimin të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07 dhe 5/09), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 01/2011

për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2011

I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpalljeje është ndarja e përkrahjes financiare për masat në vijim:

Masa 1	Ritje e konkurrencës së prodhimitisë bujqësore	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme (deri)
1.1	Investime për modernizim të ekonomive bujqësore	180.000.000,00 denarë
Nën sektor		
1.	Vreshtari	28.000.000,00 denarë Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 2.500.000,00 denarë, ndërsa për vendosje të fidanishteve deri më 3.500.000,00 denarë
2.	Pemëtari (duke përfshirë edhe rrushin për ushqim)	26.000.000,00 denarë Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 2.500.000,00 denarë, ndërsa për vendosje të fidanishteve deri më 3.500.000,00 denarë
3.	Kopshtari (sera të plastikës, sera të xhamit dhe kopshtari nën qiell të hapur dhe me përjashtim të folive për tunele)	34.000.000,00 denarë Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 2.500.000,00 denarë, ndërsa për vendosje të fidanishteve deri më 3.500.000,00 denarë
4.	Kultura të drithërave	60.000.000,00 denarë Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 4.500.000,00 denarë
5.	Kultura industriale (kultura yndyrore, furazhe, duhan duke përfshirë edhe prodhim të patates)	23.000.000,00 denarë Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 4.500.000,00 denarë
6.	Avikulturë	7.000.000,00 denarë Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 6.000.000,00 denarë
7.	Bletari	2.000.000,00 denarë Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 800.000,00 denarë
1.2	Investime për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore	13.500.000,00 denarë
1.	Kapacitete përpunuese për përpunim primar dhe parapunim të kulturave të drithërave, farave dhe bimëve yndyrore	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 6.000.000,00 denarë
2.	Kapacitete përpunuese për vezë	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 10.000.000,00 denarë
1.3	Investime në infrastrukturë për zhvillim të bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave	12.000.000,00 denarë
1.	Investime në infrastrukturë rrugore për qasje deri tek toka bujqësore	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 1.000.000,00 denarë
1.4	Shoqërimi ekonomik i ekonomive bujqësore për kryerje të përbashkët të veprimtarisë bujqësore	5.100.000,00 denarë
1.	Investime për përparim të potencialit fizik të kooperativës bujqësore	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 4.500.000,00 denarë
Masa 3	Përmirësimi i kualitetit të jetës në mjediset rurale dhe nxitje të dizertifikimit të aktivitetëve ekonomike	60.000.000,00 denarë
3.1	Përmirësimi i kualitetit të jetës në mjediset rurale	60.000.000,00 denarë
1.	Investime në infrastrukturë rrugore për lidhje të fshatrave me vendet dhe lokalitetet kulturore me rëndësi për popullatën fshatare deri në 1 km	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 10.000.000,00 denarë gjegjësisht deri më 17.000.000 denarë për investime të kombinuara – pika 1, 2 dhe 3.
2.	Investime për ndërtim dhe/ose rikonstruim të rrugëve fshatare deri më 1 km	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 10.000.000,00 denarë gjegjësisht deri më 17.000.000 denarë për investime të kombinuara – pika 1, 2 dhe 3
3.	Investime për ndërtim dhe/ose rikonstruim të shesheve, sipërfaqeve të gjelbra dhe/ose shëtitoreve në mjediset rurale deri më 15.000 banorë	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 3.000.000,00 denarë gjegjësisht deri më 17.000.000 denarë për investime të kombinuara – pika 1, 2 dhe 3
4.	Shënim dhe përmirësim të shtigjeve pyjore dhe për biçikleta	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 3.000.000,00 denarë
5.	Rregullim të vendeve për verim në mjediset rurale	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 3.000.000,00 denarë
6.	Shënim të vendeve kulturore dhe natyrore në mjediset rurale	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri 3.000.000,00 denarë

II. E DREJTA PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim, edhe atë për masat:

Subjektet	MASA 1
Ekonomia bujqësore e shënuar në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural	Masa 1.1
Shoqata dhe kooperative tregtare të cilët plotësojnë kushte për kryerje të veprimtarisë në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare ose Ligjit për kooperativa, si dhe persona juridik të cilët fillojnë me kryerjen e kësaj veprimtarie (kapacitete përpunuese për kultura të drithërave, fara dhe bimë yndyrore, vezë)	Masa 1.2
Njësitë e Vetëqeverisjes lokale	Masa 1.3
Kooperativat bujqësore	Masa 1.4
Njësitë e Vetëqeverisjes lokale	Masa 3.1

III. LARTËSIA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Mjetet janë të dedikuara për investime për furnizim të mjeteve të reja themelore, harxhime operative në lidhje me mjetet e furnizuara dhe harxhime të tjera të parapara me Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2011.

Përkrahja financiare paguhet përmes principit të ko-financimit të investimeve të mbaruara dhe të paguara nga ana e shfrytëzuesit në lartësi prej 50% nga vlera e shpenzimeve të lejuara të pranueshme për investime, përdërisa nuk është e përcaktuar ndryshe.

Përcaktimi i ko-financimit për Masën 1.1 rritet deri më 55%, 60% dhe 65% në raste kur:

- Bëhet fjalë për investime në ekonomitë bujqësore bartës i të cilave është bujk i ri;
- Për investim të ekonomitë bujqësore në vende malore dhe/ose
- Për investim në ekonominë bujqësore në vende malore dhe/ose bartësi është bujk i ri;

Përcaktimi i ko-financimit për Masën 1.2 rritet deri më 50%, dhe ulët deri më 25% në raste kur:

- Bëhet fjalë për investime në ekonomi bujqësore gjatë së cilës kërkuesi është në rangun e tregtarit të madh në pajtim me madhësinë e subjektit të theksuar në Gjendjen momentale të subjektit juridik;

Përcaktimi i ko-financimit për Masën 1.3 arrin më 100%,

Përcaktimi i ko-financimit për Masën 1.4 arrin deri më 50%,

Përcaktimi i ko-financimit për Masën 3.1 arrin deri më 70%, dhe rritet deri 80% në rastet kur:

- Bëhet fjalë për investime në vende malore;
- Bëhet fjalë për investime në infrastrukturë rrugore për lidhje të fshatrave me vendet dhe lokalitetet kulturore me rëndësi për popullatën fshatare deri më 1 km;

Përkrahja e ndarë financiare është e pakthyeshme.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DORËZOHET

Një kërkues dorëzon Kërkesë të veçantë për secilën masë, një kërkues mund të dorëzojë më së shumti dy Kërkesa veç e veç për masa të ndryshme të këtij Programi.

Një kërkues mund të dorëzojë një kërkesë për masën 1.1 - Investime për modernizim të ekonomive bujqësore nga Programi i cili përfshin një prej nën-sektoreve bujqësore në vijim: Vreshtari, Pemëtari, Kopshtari, Kultura të drithërave, Avikulturë dhe Bletari.

Një kërkues mund të dorëzojë një kërkesë për masën 1.2 - Investime për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore që përfshinë një të investimeve në vijim: Kapacitete përpunuese për përpunim primar dhe parapunim të kulturave të drithërave, farave dhe bimëve yndyrore, Kapacitete përpunuese për vezë.

Një kërkues mund të dorëzojë një kërkesë për masën 3.1 - Investime për përmirësim i kualitetit të jetës në mjediset rurale nga Programi për një prej llojeve të investimeve në vijim: Shënim të vendeve kulturore dhe natyrore në mjediset rurale, Shënim dhe përmirësim të shtigjeve pyjore dhe për biçikleta, Rregullim të vendeve për verim në mjediset rurale.

Një kërkues mund të dorëzojë një kërkesë për masën 3.1 - Investime për përmirësim i kualitetit të jetës në mjediset rurale nga Programi për një ose më shumë nga llojet e investimeve në: Investime në infrastrukturë rrugore për lidhje të fshatrave me vendet dhe lokalitetet kulturore me rëndësi për popullatën fshatare deri në 1 km, Investime për ndërtim dhe/ose rikonstruim të rrugëve fshatare deri më 1 km, Investime për ndërtim dhe/ose rikonstruim të shesheve, sipërfaqeve të gjelbra dhe/ose shëtitoreve në mjediset rurale deri më 15.000 banorë.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale pas nënshkrimit të marrëveshjes për mbështetje financiare me APFBZH, janë të obliguar që të realizojnë procedurë tenderuese për investimin e planifikuar në pajtim me Ligjin për furnizime publike.

Kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë kërkuesit e mjeteve janë të përcaktuara në Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2011, Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve sipas masave për zhvillim rural dhe Rregulloren për kushtet më të përafërta plotësuese për përkrahjen nga masat për zhvillim rural, shpenzimet e pranueshme dhe lartësinë e mbështetjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për masë veç e veç.

Kërkuesit të cilët i kanë plotësuar kushtet për shfrytëzim të mjeteve për masat 1.1, 1.2 dhe 3.1 rangohen me pikë të përcaktuar në Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve sipas masave për zhvillim rural.

Kërkuesit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit të Kontratës për ko-financim me Agjencinë.

Mjetet financiare nuk paguhet përdërisa kërkuesi në ditën e dorëzimit të kërkesës ka obligime të parregulluara ndaj Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave dhe Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural.

V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Formulari-Kërkesa për shfrytëzim të mjeteve së bashku me listën për dokumentet e duhura dhe Udhëzimit për shfrytëzuesit mund të merret në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk, dhe në qendrat më të afërta rajonale ose njësitë punuese të Agjencisë për nxitje të zhvillimit në bujqësi çdo ditë pune prej orës 8:30 deri më ora 16:30

Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe drejtpërdrejt në Agjenci në adresën:

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,
bul. "3-ta Makedonska Brigada" pn
Ndërtesa e Makedonia Tabak Blloku C
1000 Shkup**

VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuar për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2011 në gjuhën maqedonase së bashku me tërë dokumentacionin e duhur dorëzohen në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS HAP" për Thirrjen publike nr. 01/2011 dhe shënimin e numrit të masës/nën-masës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për humbjen apo hapjen e parakohshme të kërkesës

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 09.11.2011. Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren në shqyrtim

Informata më të hollëshme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën:

ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb-faqen: www.ipardpa.gov.mk.

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për aprovim të projekteve.

Telefoni 02 3097460, çdo ditë pune prej ora 10.00 deri në ora 16.00

E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk